



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 13 tetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 28 paragrafët 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 5 paragrafët 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, nenit 1 paragrafët 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullores Nr. 04/2023 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr. 750 /2023 të datës 13 tetor 2023 shpall:

KONKURS

Për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme si në vijim:
 - 1.1 Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - 1.2 Të mos jetë i dënuar për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.3 Të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.4 Të ketë vlerësim të dalluar apo të mirë të performancës në dy (2) vlerësimet e fundit të rregullta;
 - 1.5 Të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
 - 1.6 Të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jo-publike në pesë (5) vitet e fundit.

II. Përveç kriterëve të përgjithshme për të ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta si në vijim:

1.1 Kandidati duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune si prokuror.

III. Kandidatët e interesuar për Kryeprokurorë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duhet të dorëzojnë:

- formularin për aplikim;
- formularin për vetëvlerësim;
- formularin e koncept dokumentit (janë të publikuara në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës);¹
- autobiografinë (CV);
- certifikatën nga gjykata;
- çfarëdo dokumenti tjetër relevant për të dokumentuar përvojën e tyre përfshirë rekomandimet;

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

V. Aplikacioni, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura, duhet të dorëzohen nga data **16 tetor 2023 deri më 3 nëntor 2023** te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e gjashtë (6) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 603, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Formularët e kërkuar në pikën 1, 2 dhe 3 janë të publikuara në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe mund t'i gjeni në vegzën: <https://prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/>